



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KUKËS

Nr. 419/18 Prot.

Kukës, më 15.12.2025

VENDIM

Nr. 13 Datë 15.12.2025

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT KUKËS**

Bazuar në ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Proedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit Nr.152/2013 të miratuar me datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, (*i ndryshuar*) VKM Nr.142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës me institucionet e administratës shtetërore”, ligjit Nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH“ (*i ndryshuar*), ligjit Nr.9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike“, Vendim nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, Ligji nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, Këshilli i Qarkut Kukës në mbledhjen e datës së mësipërme;

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren për organizimin dhe funksionimin e administratës së Këshillit të Qarkut Kukës, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Qarkut Kukës, Kryetari, Sekretari i Këshillit të Qarkut Kukës, si dhe Drejtoria e Finances, Juridike, MBNJ-se dhe Sherbimeve mbeshtetëse.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

Miratuar me : 8 vota
Pro: 8
Kunder: 0
Abstenim: 0
Zbardhur me: 15.12.2025

KRYETARI
Astrit Dobrush

